REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN
- KRYESUESI-
15 Nr. 06-11
Lipjan, më 16.11.2026

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

z._____

**Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe në bazë të nenit 7 të Rregullorës së Punës të Kuvendit të Komunës së Lipjanit,**

**THËRRAS**

**Mbledhjen e 11-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit për të Enjtën, më 26.11.2026, në sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit, me fillim në ora 10,$^{00}$**

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

**REND DITE**

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 10-të e Kuvendit.
2. Propozim Rregullore për shërbimet publike dhe rendin komunal.
3. Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK-Lipjan.
4. Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit – Raporti i Auditimit të Paluajtshmërisë "Dhënia në shfrytëzim dhe menaxhimi i pronave komunale të dhëna me qira në Komunën e Lipjanit" për periudhën 2024-2025, dhe Plani i zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Zyrës Kombëtare të Auditimit.
5. Raporti i Kryetarit të Komunës për periudhën Janar-Qershor 2026 mbi gjendjen e pronave komunale të cilat janë dhënë në shfrytëzim afatgjatë.
6. Propozim Vendim për formimin e Komisionit përzgjedhës Ad.hoc për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në institucionet publike edukativo-arsimore të Komunës së Lipjanit.
7. Deklaratë mbështetëse mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike.
8. Propozim Vendim për miratimin e Planit Orientues të Punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2027.

Së bashku me ftesë ju dërgojmë materialin për pikat e rendit të ditës së propozuar.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E LIPJANIT KUVENDI I KOMUNËS XV SKUPŠTINA OPŠTINE OPŠTINA LIPLJAN REPUBLIKA KOSOVA

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Daut Azemi**